
	<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova – Republic of Kosovo</b>  <b>Komuna e Prishtinës</b> <b>Opština Priština –Municipality of Prishtina</b>	
---	--	---

<b>Datë/a:</b>	29.03.2019
<b>Për/ Za/ To:</b>	MARIMANGA
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.03.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “MARIMANGA”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e transportit me marimangë”RITENDER LLOT I, me Nr. të Prok: 616 18 069 211 nxjerr:

## V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik “MARIMANGA”, të dt. 27.03.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e transportit me marimangë”RITENDER LLOT I, me Nr. të Prok: 616 18 069 211, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, të datës 22.03.2019 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.**
2. **Anulohet vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 22.03.2019.**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin ta kthejë në Rivleresim.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### **A r s y e t i m**

Eshte konstatuar se pjesa dermuese e pretendimeve jane te pabazuara dhe si te tilla jane sqaruar edhe ne vendimet paraprake.

I vetmi pretendim i bazuar eshte pika 1.2.B.i cili ka te beje me ndryshimin ne mes te automjetit te paraqitur ne marrveshjen per shfrytezim dhe deshmime te ofruara, respektivisht marrveshja ka te beje me automjetin me targa 645-KS-024, ndersa deshmia eshte per rimorkion me targa 630-KS-397.

Bazuar ne kete pretendim u vendos si ne dispozitiv te vendimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.**

#### **Këshilla juridike:**

**Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**

